



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Maj-2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, gjatë muajit maj të vitit 2019, ka arritur me sukses dhe në kohë optimale t'i realizojë të gjitha punët dhe detyrat e parapara sipas planit të veprimit dhe punëve dhe detyrave tjera të paraqitura.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas plan programit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formohet Asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);

- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me te gjitha palët e interesit);
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartohet Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Zbatohet Plani për zhvillimin profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në koordinim me zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Planifikimi për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore për vitin kalendarik 2019-2020;
- Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në nivelin përgatitor dhe fillor, klasa e parë, për vitin shkollor 2019-2020;
- Shpallja e konkursit për pranimin e nxënësve në klasë përgatitore dhe klasë të parë në institucionet edukativo-arsimore për vitin shkollor 2019-2020;
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;

- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Bëhet identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë/ kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Përgatitja e organogramit të Drejtorisë së Arsimit;
- Përgatitja e raportit mbi Garat e Diturisë, të organizuar nga koordinatori Nacional, Rini, Kulturë dhe Sport;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është duke u organizuar trajnimi “Udhëheqje arsimore”;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë. Nuk është mirë të duplikohet inspektimi);
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;

- DKA përkrah NNV dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Fillimi i implementimit të tenderit për furnizim të institucioneve edukativo-arsimore me kabinete të fizikës, kimisë dhe biologjisë;
- Furnizimi me pajisje muzikore për kabinete të muzikës;
- Fillimi i implementimit të projektit "Furnizimi me kabinetet e stomatologjisë dhe fizioterapisë i shkollës "Dr. Ali Sokoli";
- Organizimi i trajnimit për aparatet kundër zjarrit të institucioneve arsimore etj.;
- Fillimi i zbatimit të projektit "Furnizimi i shkollave me inventar";
- Fillimi i zbatimit të projektit "Furnizimi i shkollave me perde";
- Furnizimi me material higjienik i shkollave;
- Furnizimi me kifle i nxënësve të nivelit të arsimit fillor;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, këshilluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit

prill të vitit 2019, kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 6 vizita kontrolluese në institucionet edukativo-arsimore, ku zhvillohet mësimi joformal, në: "SHML "Gjin Gazulli", SHML "7 Shtatori", SHML "28 Nëntori", SHML "Abdyl Frashëri", SHFMU "Emin Duraku", një vizitë e përgjithshme në shkollën fillore "Afrim Gashi" dhe vizitë speciale në shkollën fillore "Shkëndija", "Gjergj Fishta" dhe shkollat e mesme "Abdyl Frashëri" e gjimnazin "Ahmet Gashi".

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe avancimeve të proceseve arsimore, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t'i zgjedhë 17 koordinatorë të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, pedagogë të përgjithshëm apo mësimdhënës kompetent për këtë detyrë. Andaj, duke ditur rolin dhe ndikimin e madh që do ta ketë koordinatori i cilësisë në nivel shkolle për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, DKA-ja për këtë pozitë ka vendosur kriteret shtesë, kriteret të cilat do të garantojnë përzgjedhje cilësore për pozitën e KC-së;

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, konkretisht Divizionin për Sigurimin e Cilësisë, Standardeve, Monitorimit dhe Licencimit, gjatë muajit maj 2019, kanë realizuar testin vlerësues për shkallën e parë (I), të tretën (III) dhe të pestën (V), të kurrikulës.



Andaj, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës së kurrikulës së Arsimit

Parauniversitar të Republikës së Kosovës, **Neni 8. Vlerësimi për shkallë, Pika 8.2.** Vlerësimi për shkallë është realizuar në nivel shkolle për fushë/lëndë dhe përfshin vlerësimin me rastin e përfundimit të shkallës – në fund të shkallës I, II, III dhe V (klasa 2, 5, 7 dhe 11), **Pika 8.6.**

Prandaj, instrumenti për vlerësimin e shkallës është përgatitur dhe hartuar në mënyrë të standardizuar nga MASHT-i, i cili është administruar dhe kontrolluar nga shkolla dhe është monitoruar nga Drejtoria e Arsimit.

Andaj, vlerësimi për vitin 2018-2019, është realizuar për këto shkallë:

shkallën e parë (I), në lëndët: gjuhë shqipe dhe matematikë;

shkallën e tretë (III), në lëndët: gjuha shqipe, gjuha angleze dhe matematikë;

shkallën e pestë (V), në lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze dhe matematikë, ndërsa për shkallët tjera nuk do të realizohet vlerësimi në këtë vit.

- **Gara ndërkombëtare e matematikës**

Në funksion të identifikimit të talenteve të reja, mbështetjes së tyre në rrugën e dijes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, Drejtoria e Arsimit në koordinim me studentët të Republikës së Kosovës që studiojnë në Universitetin e Koprit, në Slloveni, në koordinim me këtë universitet, më datë 02 maj 2019, organizuan garën në lëndën e matematikës, në objektin e gjimnazit të specializuar “Matematikë”.



Gara u realizua me nxënësit e klasave XII, të cilët janë të interesuar për të vazhduar studimet në degën e matematikës në

Universitetin e Primorskës, të Republikës së Sllovenisë.

Është viti i dytë që realizohet një garë me karakter të tillë në Komunën e Prishtinës dhe shpresojmë që në vitet në vijim një garë e tillë të marrë edhe një dimension me të gjerë në vendin tonë.



Në këtë garë pjesëmarrës ishin nxënësit e klasave të dymbëdhjeta (XII), të cilët

pasi kanë treguar shkathhtësi dhe kompetencë të larta në garat e zhvilluara në shkollat e tyre, iu nënshtruan testit në nivel komune.

Andaj, kandidatët më të suksesshëm nga garuesit pjesëmarrës të komunës sonë, do të fitojnë të drejtën për të studiuar në Republikën e Sllovenisë, me bursë të plotë, në vlerë të 4.500€;

- **Gara e diturisë.**

Më 11 maj 2019, në Komunën e Prishtinës është mbajtur “Gara e diturisë” nga Zyra e koordinatorit nacional për kulture, rini dhe sport.

Andaj, në mënyrë që ky proces i garës të rrjedhë sipas standardit dhe dinamikës së paraparë, Drejtoria e Arsimit më 11 maj 2019, ka mobilizuar të gjithë stafin e saj, të cilët kanë përcjellë nga afër gjithë organizimin dhe ecurinë e testimit, ku nga vizitat kanë vërejtur se ka pasur lëshime të mëdha profesionale nga organizatorët e garës, gabime dhe lëshim të mëdha profesional në përpilim të pyetjeve, mungesë të testeve dhe shumë defekte të mëdha, të cilat e kanë bërë një garë jo serioze, jo profesionale dhe dëmtuese për proceset arsimore.

Po ashtu, nga raportet e dërguara nga drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, theksohet se sa i përket punëve dhe detyrave të tyre, janë bërë të gjitha përgatitjet në kohë të duhur për garën, por ankesa të mëdha janë adresuar në drejtim të organizatorit, të cilët kanë konstatuar se organizimi i garës nga Zyra e Koordinatorit ka qenë në nivelin më të dobët të mundshëm, ku ndër to kanë potencuar, arritjen e testeve në shkollë me vonesë në mes të natës, gabimet profesionale në teste, mungesa e testeve për disa klasë etj. Po ashtu, në disa shkolla kësaj gare iu kanë përgjigje një numër i vogël i nxënësve dhe ka pasur reagime të mëdha nga edhe nga prindërit për këtë garë.

Ndërsa, në shkollat ku nuk është mbajtur testi si pasojë e mos dërgimit të testeve, janë: SHFMU "Ismail Qemali", SHFMU "Pavarësia", SHFMU "Shkëndija", SHFMU "Afrim Gashi", SHFMU "Nëna Terezë", ndërsa në shkollën "Elena Gjika" dhe SHFMU "Naim Frashëri", testi nuk është mbajtur për komunitetin turk dhe boshnjak;

- Ka filluar procesi i vlerësimit të garës në nivel komune, për kreativitet kulturor dhe mendim kritik, për nivelin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Garë e organizuar në koordinim me Zyrën e Koordinatorit nacional për kulturë, rini dhe sport;
- Drejtorja e Arsimit, në funksion të proceseve reformuese dhe zhvillimeve në arsim, gjatë muajit maj 2019, ka organizuar trajnim për zhvillimin profesional të punëtorëve të bibliotekave shkollore të Komunës së Prishtinës. Trajnimi është mbajtur nga Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës, ku qëllimi i trajnimit ishte aftësimi profesional i

bibliotekistëve për: pasurimin e materialeve bibliotekare, klasifikimin e materialeve në bibliotekat shkollore, katalogimin e materialeve bibliotekare dhe puna edukativo-arsimore me nxënës në bibliotekë.

Drejtorja e Arsimit, ka vlerësuar se "Trajnimi profesional i punëtorëve të bibliotekave shkollore

nga fusha e bibliotekarisë", është shumë i nevojshëm për zhvillimin dhe funksionimin e bibliotekave shkollore, sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara, mbase Drejtorja e Arsimit vite me radhë është duke investuar dhe pasuruar bibliotekat shkollore me tituj të ri.



Po ashtu, në program është përfshirë edhe puna edukativo-arsimore me nxënës rreth zhvillimit të shprehive të leximit gjatë gjithë jetës.



- Drejtoria e Arsimit në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, ka arritur t'i vendosin në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar kutitë e ankesave, të cilat do të shërbejnë dhe do t'u mundësojnë nxënësve që të paraqesin çdo ankesë anonime për çdo shqetësim që ju paraqitet atyre në institucionin arsimor dhe, në veçanti puna dhe sjelljet e mësimdhënësve.



Andaj, në funksion të këtij procesit më datë 03 maj 2018, Drejtoresha e Arsimit znj. Shpresa Shala, me bashkëpunëtorë dhe në koordinim me inspektorët e arsimit, vizituan shkollat: SHML "Xhevdet Doda", SHFMU "Xhemail Mustafa" dhe SHFMU "Dardania", ku bashkë me drejtuesit e shkollës realizuan hapjen e kutive dhe shqyrtuan të gjitha ankesat e adresuara.

Po ashtu, më këtë rast u inkurajuan nxënësit dhe i gjithë komuniteti i shkollave që të shkruajnë ankesa apo lëvdata për shkollën dhe t'i vendosin ato në kuti, ndërsa komisioni i formuar brenda shkollës do t'i trajton ato.

- Takime me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe psikologët e shkollave.
- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj të vitit 2019, ka vazhduar procesin e takimeve me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe psikologët e shkollave, ku në këtë takime janë trajtuar me theks të veçantë çështjet, mbarëvajtja dhe ecuria e procesit edukativo-arsimore në të gjitha dimensionet, funksionimi i organeve dhe mekanizmave të brendshme të shkollës dhe bashkëpunimi në mes drejtuesve të shkollave e mësimeve të shkollave të caktuara, rreth implementim dhe zbatimit në praktikë të KK-së. Po ashtu, psikologët e shkollave janë angazhuar me mbajtjen e ligjëratave, me tema të ndryshme, me nxënës të shkollave të mesme, si masë për mbrojtjen nga dukurit negative;
- Pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi operimin dhe funksionalizimin e Drejtorisë së Arsimit, është konstatuar që në këtë segment ka nevojë imediate për riorganizim të institucionit, sipas kërkesave dhe standardeve të kohës, duke planifikuar riorganizimin në përputhje me kërkesat dhe nevojat e institucionit, gjë e cila do të garantonte funksionimin e saj me më efikasitet dhe me rezultate të larta, andaj në këtë segment është përgatitur organogrami, komfor standardeve dhe kërkesave të DKA-së;
- Drejtoria e Arsimit, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë duke e zhvilluar trajnimi për udhëheqje arsimore, ku nga komuna janë këtë trajnim janë duke e ndjekur 8 mësimeve;
- Aktivitetet profesional (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund të muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentorua nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Më 31 maj 2019, në autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit, u organizua "Testi i arritshmërisë" në nivel vendi, me nxënësit e klasave të nënta (IX). Këtij testit në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 3530 nxënës.

Drejtoria e Arsimit për një proces të drejtë dhe të standardizuar, ka ndërmarre të gjitha masat e domosdoshme, duke organizuar testin në njëmbëdhjetë (11) qendra dhe duke krijuar kushte sipas standardeve më të mira për punë, gjë që

ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe shpresojmë edhe në rezultate më të mira dhe reale;

Për një proces të mirëfilltë të testimin dhe vlerësimit të standardizuar, ka realizuar formën e organizimit të “Testit të arritshmërisë”, një nxënës një bankë, dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi;

- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
Organizimi dhe zhvillimi i mësimin joformal, është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët. Ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues nëntë (9) nxënës-fëmijë, nga ta tre janë referuar në institucione parashkollore, një në Qendër Burimore dhe pesë në shkolla të rregullta. Diagnozot e tyre kanë qenë: zhvillim i vonshëm intelektual, çrregullim i spektrit të Autizmit, vonesë në të folur, epilepsi. Andaj, për procesin e vlerësimit, ekipi vlerësues ka përgatitur raport për secilin fëmijë-nxënës dhe u është dërguar shkollave apo institucioneve parashkollore, ku shkollat, IP, pastaj iu kanë përcjellë edhe prindërve.
- Realizimi i praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale gjatë muajit maj, është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm. Kjo është si pasoj e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe, njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhunë apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;

- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit maj;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Furnizimi me kifle i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V);
- Është organizuar trajnimi për drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore lidhur me përdorimin e aparatet kundër zjarrit;
- Është përgatitë, bashkë me kompaninë “Deloitte”, plani i biznesit për themelimin e ndërmarrjes publike “ Kuzhina Qendrore”;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbajtja e evidencës së lëndëve të zotuar me modul blerje, si dhe dorëzimi në prokurim.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Formohet Asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve;
- Hartohet Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimitdhënës dhe administrativ;
- Paraqitja e provimit të Maturës shtetërore;
- Procesimi i të dhënave me nxënës për secilin institucion;
- Krijimi i qendrave testuese;
- Angazhimi i administruesve për monitorimin e procesit të Maturës shtetërore 2019;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;

- Kontrollimi i shpenzimeve (subvencioneve) në institucionet parashkollore me bazë në komunitet.

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese maj – 2019.

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 05-2019				
Maji-2019	Alokim	Shpenzim	Zotim -Oblig.	Mbetje -S=
Paga	1,576,733.06	1,576,733.06	-	-
Komunali-10	31,749.06	-	8,908.83	22,840.23
Komunali-22	450,000.00	390,679.17	-	59,320.83
Mallra dhe Shërbime-10	409,727.03	176,259.20	104,138.41	129,329.42
Mallra dhe Shërbime-21	241,716.89	180,473.22	28,476.56	32,767.11
Subvencione	111,133.83	63,020.00	8,908.83	39,205.00
Donacione	9,529.87	2,229.00	200.00	7,100.87
Investime Kapitale-10	350,000.00	-	18,000.00	332,000.00
Investime Kapitale-21	1,041,097.95	175,149.62	173,126.86	692,821.47
Investime Kapitale-22	1,909,120.18	5,996.19	-	1,903,123.99
Gjithsej:	6,130,807.87	2,570,539.46	341,759.49	3,218,508.92

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit maj ka realizuar mbi 137 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara në katër ditë të javës.

4. Takimet me institucione të tjera.

Për periudhën e muajit maj të vitit 2019, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- anëtarët e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe ndërmarrësi;
- përfaqësuesit e Zyrës së koordinatorit nacional për kulturë, rini dhe sport;
- përfaqësuesit e GIZ-së;
- përfaqësuesit e KLSP-së;
- përfaqësuesit e EU-së;
- përfaqësuesit e kolegjit AAB-së;
- përfaqësuesit e ALLED-së;
- inspektorët e arsimit;
- përfaqësuesit e Policisë;
- përfaqësuesit e organizatës "Evolution";
- përfaqësuesit e KURP "Prishtina";
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

- Gjatë muajit maj në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- Gjatë muajit maj janë pranuar gjithsej 63 lëndë, prej tyre të miratuara janë 12, të refuzuara 20, të pezulluara 4, të anuluar 2 dhe në proces janë 25 lëndë.

6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me aktivin e grafikës së shkollës së mesme "28 Nëntori";
- Takim me mësimdhënësit e edukatës fizike;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në vazhdim:

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Kërkesat e mëdha për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë në disa shkolla të qytetit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimin e punëve dhe detyrave;
- Implementimi i kurrikulës së re.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Krijimi i ekipit profesional në nivel të DKA-së për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore, për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;

- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkolle), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Monitorimi i programeve të zhvillimit profesional;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;
- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2019/2020;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht

sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;

- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-së në shkolla;
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartimi i programit të investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Analizë dhe vlerësim i përgjithshëm mbi fondin e orëve mësimore dhe sistemimin, plotësimin e fondit të orëve për mësimdhënësit që janë të rrezikuar të mbesin pa orë ose me më pak orë mësimore;
- Shpallja e konkursit për pranimin dhe lirim nga pagesa të fëmijëve në institucionet parashkollore, për vitin kalendarik 2019-2020;
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, për vitin shkollor 2019-2020;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;

- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Përgatitja e projektit për furnizim me pajisje teknologjike të shkollave etj.;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me kabinete të fizikës, kimisë dhe biologjisë;
- Furnizimi i shkollës “Dr. Ali Sokoli” me kabinetin e stomatologjisë dhe fizioterapisë;
- Furnizimi me inventar të shkollave;
- Furnizimi me material higjienik të shkollave;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik të shkollave etj.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen, e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.